



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:054192

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05405034

PKR.nr. 112/12

NË EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi, dhe anetaret e trupit gjykues gjyqtarët Agim Ademi dhe Menderes Behluli, në çështjen penale të të akuzuarit K.S nga Gjilani, të cilin e mbron sipas autorizimit Av. Elvira Haziri nga Gjilani , për shkak të veprës penale, knosje nga neni 161 par.2 te KPK-se, e sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore - DKR në Gjilan, PP.nr.45/2012, e dt.16.03.2012, e pas mbajtjes e shqyrtimit gjyqësor me dt. 16.02.2024 shpall, ndërsa me date 04.03.2024 përpilon:

A K T G J Y K I M

Ndaj te akuzuarit K.S, nga babai R.... dhe nëna R, e lindur P, i lindur me datënë Gjilan, ku edhe jetonka te kryer shkollën e mesme, i punësuar në Zvicër, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes se mesme, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

Ne baze te nenit 362 para.1 pika 1.3, nenit 453 dhe 462 par. 3 te KPPRK-se,

REFUZOHET AKUZA

SEPSE

Me datën 18.02.2012, rreth orës 24:00 ne Gjilan,i pandehuri me dashje e ka kanosur tani të dëmtuarin Rr.R nga f. Malishevë K. Gjilan, në atë mënyrë që gjersa i demtuari ishte duke qarkulluar me veturën e tijë të markës "M..." me targa të regjistrimitnëpër qytet, për ballë Postës se madhe, fillimisht i pandehuri ia blendon me drita (i jep sinjal) duke e parë këtë gjendje i dëmtuari e ngadalëson shpejtsine, ku i pandehuri me veturën e tijë të markës "O..K" me targa të regjistrimit..., me ngjyrë të kaltërt e godet me anën e djathtë të veturës së tijë, veturën e të dëmtuarit në anën e majtë ne derën e vozitsit ku ishte në veturë, por duke e parë këtë gjendje i demtuari merrë një shpejtsi me veturë dhe ikë nga vendi i ngjarjës me qëllim që ti shmangë veprimet e të pandehurit, për shkak të një konflikti të mëhershëm ndërmjet tyre, e më pasë i demtuari lajmrohet në Stacionin policor në Gjilan.

- Me çka kishte për të kryer veprën penale kanosje nga neni 161 par.2 te KPK-së.

Shpenzimet lidhur me këtë lëndë mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të KGJK-së.

I demtuari Rr.R per realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhezohet në contest civil.

ARSYETIM

Prokuroria Publike e Qarkut në Gjilan me dt.16.03.2012, ka ngritur aktakuzën PP.nr.45/2012 ndaj të akuzuarit K.S për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 147 lidhur me nenin 20 të KPK-së, dhe ka kërkuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të njejtin t'a shpall fajtor dhe të denohet me denim meritor sipas ligjit.

I akuzuari në asnjë fazë të procedurës penale nuk e ka pranuar fajsinë.

Procedura e provave;

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit Rr.R, ka Mbetë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori e dhënë me dt.12.03.2012.

Në këtë kohë për të cilën po flasim unë kam punuar taksist, ashtu që ditën kritike unë duke vozitur veturën taksist, aty afër ambullantës së qytetit, dikush ma ka qitë dorën duke më dhënë shenjë të ndalem, e kam marr atë person e kam qu te M...E... dhe kur jam kthyer për qytet, kur ka mbërri te restorant L tash asht I na, duke vozitur nga qendra e qytetit e kam vërejtë një veturë që pom vjen mbrapa. Kjo veturë ka qenë O.. C... ngjyrë e kaltër, më ka blindu me drita, ishte natë diku ka ora 23-24. Është kthyer me shkuar ka postën e madhe, përsëri më ka blindu ka ardhur paralel me veturën time, më ka kshyr, e kam vërejtë që është K. Ka filluar me rritë shpejtësinë, pastaj K me veturën e tij e ka goditur veturën time për mbrapa, përsëri më ka goditur në derën e pasme ka shoferi edhe njëherë në derën e parë te shoferi. aty e ka humbë kontrollin me veturën time, është mundu mem ndal, i njëjti e ka pas revolen në dorë e tu ma bo me dorë sikur tu thon nale, apo dil prej kerri. Unë kam vazhdu me ikë me kerr me shpejtësi, jam shkuar ka shkollat e mesme e drejt në Stacionin e Policisë e kam lajmëru rastin. Pastaj policia është marrë me këtë rast. Në veturë unë kam qenë vet. Në veturën e tani të akuzimit kanë qenë 3-4 persona. Unë konsideroj që qëllimi i Kt ka qenë te rasti që ka ndodhë ma herët në 2011, për të cilin jemi duke u gjykuar dhe ka dasht mu hakmarr. K më ka njoftur që jam në lidhje gjaku me të akuzuarin A për rastin e 2011. Ky kur më ka identifikuar, kur ka ardhë paralel me veturën time te postën e madhe dhe atëherë ka filluar me më goditë me veturë.

Kn nuk e ka njoftuar ma herët. Normalisht unë jam shqetësuar-frigu. Nuk kam qenë për trajtim mjekësor, sepse nuk ka pas lëndime. Më kujtohen ato skena. Prej atëherë nuk punoj taksist i rregullt veq me telefonata.

Prej ditës së parë unë kam deklaruar se K ka pas revole në dorë ditën kritike. K kur më ka blindu ma herët sigurisht ka dashtë me vërtetu se kush jam unë dhe vetëm kur ka ardhë paralel më ka pa mu dhe ka fillu me më goditë me veturën e tij. Te posta kur ka ardhë paralel me veturën time K, ka qenë ndriqim i mirë sikur tash, sepse ka qenë shumë afër. Unë konsideroj që K ka dashtë me mu hakmarrë me rastin që thash me herët, për shkak se me veturën e tij e ka godit dy herë veturën time. Jashta asaj dite unë me K kurrë kam pas problem, por as me kërkend tjetër. Unë vetëm kam qillu në veturë me A kur ka ndodhë rasti i 2011 dhe aty sigurisht më ka pa K dhe për këtë ka dashtë me mu hakmarrë. Vetura ime ka qenë Mercedes ngjyrë e përhimtë.

Unë e kam përmendur punën e armës edhe në prokurori edhe në polici, por qudi që nuk e kanë theksu. Mu këto deklarata nuk mu kanë dhanë me i lexu. Dritarja e veturës së Kt e pasagjerit ka qenë e mbyllur, za nuk kam ni të tij. K ka pas edhe pasgjer ul në ulësen e parë. Kur ma ka goditë veturën time K revolen e ka pas në drejtim timin. Kur jam nal dhe i kemi bo kerret paralel, K ka mujt edhe mem vra, por xhami i veturës nuk ka qenë i hapur.

Kam pasur veturën e dëmtuar në vendet ku e ka goditur vetura e K, për këtë janë fotot. Nuk e di se a ka qenë e dëmtuar vetura e K kur e ka godit veturën time.

Dëshmitari **B.Th**, zyrtar policer ka deklaruar, se lidhur me ngjarjen për të cilën jam ftuar në bazë të shkresave të lëndës, vërehet se me dt.22 shkurt 2012 kem pranuar një autorizim nga prokurori –kërkesë për grumbullim të informatave kuk është kërkuar të intervestohen i pandehuri K.S, i dëmtuari Rr.R, është kërkuar të bëhet fotografimi i dy veturave O. C... me targa...., pronë e të akuzuarit K.S dhe vetura e llojit Mercedes 190 pronë e të dëmtuarit Rr.R me targa.... Si pikë tjetër ka qenë të bëhet krahasimi i fotografimeve- konkretisht të bëhet krahasimi i ngjyrave, po ashtu është kërkuar që të merren evidencat nga Spitali i Gjilanit, mos i akuzuari K.S ka kërkuar ndihmë me dt. 18.02.2012. Me datë 22.02.2012 nga njësitë i krim teknikës është bërë fotografimi i dy veturave, fotografimi është bërë në ato pjesë ku dyshohet se ishin të dëmtuara, **me q'rast është vërejtur që vetura Mercedes është goditur në derën e përparme nga ana e shoferit, ndërsa dëme tjera nuk janë vërejtur**. Ndërsa sa i përketë veturës O. C e cila është fotografuar në oborrin e të dyshuarit K.S, është vërejtur një shejë dëmtimi në anën e djathtë të sajë, dyshohet se me të njëjtën pjesë është goditur vetura Mercedes. Te vetura O. C në pjesën ku dyshohet se e ka goditur veturën Mercedes, vërehet ngjyrë e bardhë, por nuk kemi mujt me përcaktu se a është ngjyrë e automjetit Mercedes.

Dëmtimet që i kemi konstatu na te vetura Mercedes, janë dëmtime në anën e majtë te dera e vozitësit, nuk kemi konstatu tjera.

Prokurori i shtetit I ka propoyu gjykatës që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet zyrtari policor B.A, ekspert i kriminalistikës i cili është marr me rastin, ndërsa heqë dorë nga dëgjimi i dëshmitares A.V.

Dëshmitari B.A, zyrtar policor, ka thënë se është e vërtetë, që e ka bërë fotografimin e dy vetura Mercedes dhe Opell Corsa. **Vetura Mercedes ka qenë e dëmtuar në derën e majtë ka shoferi, e kemi fotografuar ate dhe tjetër skemi ndërhy kurgja sepse nuk ka mundësi**. Pastaj kemi shkuar në Dhe të Bardhë te shtëpia e K.St, ku e kemi fotografuar edhe veturën e tij Opell Corsa. Te kjo veturë në mbrojtësin e parë anën e djathtë përpara e kemi vërejtë një

dëmtim, mbrojtësi i plastikës ka qenë i dëmtuar, i gërvishur. Kena dyshu se te Corsa ka pas ngjyrë të Mercedesit të dëmtuar, por nuk kemi mujt na me nxjerrë. Në bazë të dëmtimeve që i kena pa na aty, na e ka marr menja që është e njëjta.

Fotografimin e kemi bërë në të dy veturat me datë 22.02.2012, nuk e dij pse nuk është bërë ma herët.

Prokurori i shtetit heqi dorë nga propozimi që në seancë të ftohet një ekspert i mekanikës (autolimar) lidhur me vëretimin- konstatimin lidhur me automjetet e tyre gjatë fërkimit dhe gjurmave në veturë.

Leximi I shkresave;

-shikohet fotodokumentacioni nga shkresat e lëndës, sipas te cilit vetura {Mercedes} vrehet në derën e vozitsit e demtuar-e shtypur, ndërsa vetura O. K ka një dëmtim në anën e djathtë në mbrojtësin e përparëm.

Lexohet raporti i forenzikës i datës 22.02.2012, ku jan pershkru demtimet e veturave siq u permenden me larte.

Mbrojtja e të akuzuarit;

I akuzuar K.S ka mbetë në tërësi pranë deklaratave të dhëna në prokurori dhe polici, pa ndryshim dhe plotësim. Natën kritike kam qenë te restoran P... në Gjilan në lagjen, ka qenë edhe 17 shkurti dita e shpalljes së Pavarsisë. Unë jam kon me një shoqe atë ditë, të cilën nuk e kam pa ma. Në këtë restoran unë kam shkuar rreth orës 24:00 dhe kam qëndru dikun nja 15-30 minuta. Si kam dal prej restorantit kam shku deri në Spital të Gjilanit, se mora vesh se do shok të mi janë rreh me dikon dhe kam shku mi vizitu. Unë kam qenë me veturën time O... C..., pasi i kam vizitu ata shokë, pas një kohe të shkurt kam dal dhe kam shku në drejtim të Dheut të bardhë të shtëpisë sime. Jam nalë pa mbri te shpija, pastaj e kam dërgu at vajzën në rrugë të Prishtinës, prej aty kam shku në shtëpi. Gjatë qesaj kohe nuk e kam pa asnjë shok gjatë rrugës, nuk më kujtohet. Natën kritike nuk e kam pa personin Rr.Rn. Me Rr as nuk kam pas problem e as nuk kam. Nuk kam pas arsye unë me ju hakmerr Rr. Prej 2012 e deri sot nuk kam kry asnjë vepër penale. Pasi më ka ndodhë aj rasti i pare, për të cilin jemi duke u gjykuar, unë nuk kam dal prej shpisë një vit. Atë natë për të cilën po bohet fjalë, baba ma dha kerrin dhe kam dal për të festu. Natën kritike as që e kam pa Rr, ndoshta Rr më ka pa mu, por unë nuk kam pas interes. Është e vërtetë se unë kam kalu ka Posta e madhe atë natë, por se kam pa Rr. Veturën O. C e ka ble një natë përpara prej një shoku të quajtur B. Dëmtimet për të cilat po folët, me siguri i ka pasur se ashtë veturë e vjetër. Unë jam arrestu për këtë rast mas nja 2 dite, por nuk kam qëndru në paraburgim. Nuk e dij se qfarë vetura ka pas Rr. Qëllimi ka qenë mu bo baraz një me një për rastin e mahershëm dhe mas një jave kanë dërgu njerëz dhe na kanë thonë se tash jemi një me një.

Konsideroj se 100% vetura ime ka qenë e grithhtë, se ka qenë e vjetër. Natën kritike kam qenë me atë qiken. Tekam pi raki por është kohë e gjatë sum kujtohet. Unë kam qenë në gjendje të dehur, por jam konë në kontroll edhe pse kam qenë i dehur. Natën kritike as smë ka goditë kërkush e as nuk e kam goditë kërkend. Nashta si figurë e kam njoft Rr e jo më tepër. Nuk e dij diferencën kohore nga konflikti i pare, te ky që po pretendohet tash.

Fjala perfundimtare;

Prokurori i shtetit deklaroi, se sa i përketë aktit akuzues kundër tani të pandehurit, mbesim në tërësi pa ndryshime dhe plotësime, me arsyetim se të gjitha provat që janë shtjellu si ato materiale, fotodokumentacionit, dëshmia e dëshmitarit B.A, i cili në mënyrë të qartë sqaron se dëmtimet në veturat në njërin anë, ndërsa në anën tjetër edhe dëshmia e dëshmitarit B.Th t lidhur me raportet në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit. Gjithashtu për shkak të një konflikti paraprak që kanë pas në mes dy familjeve e gjithë kjo na bënë të kuptojmë, për qëllimin e kryesit dhe pasojat edhe pse kjo vepër mund të kryehet edhe me mjet të rrezikshëm motorik. Gjykata me rastin e shtjellimit të këtyre provave të merr një vendim të mirë dhe të ligjshëm, duke marr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese në mënyrë që një dënim në suaza të ligjit të jenë të arsyshme.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit, av.Elmi Qerimi deklaroi: mendoj se për veprën penale sipas nenin 147 lidhur me nenin 20 të KPK për të cilin është akuzuar i akuzuari K.S, gjatë shqyrtimeve gjyqësore është arritët të dëshmohet në tërësi.

Nga të cekurat nuk do të lëshohem në analizimin e kësaj qështje penale, por jam i bindur se trupi gjykues i cili e shqyrton këtë qështje do të vendos objektivisht pamarr parasysh se kujt do ti konvenoj ky vendim.

I dëmtuari Rr.R deklaroi:e përkrahi fjalën përfundimtare të avokatit pa ndryshim dhe plotësim.

Mbrojtësja e të akuzuarit av.Elvira Haziri deklaroi:Prokuroria Pulbike e Qarkut në Gjilanka ka ngritur aktakzue kundër të pandehurit K.S me dt. 16.03.2012 dhe pretendimet se i njëjti ka kryer veprën penale vrasje në tentativë nga neni 147 lidhur me nenin 20 të KPK-s . Mbrojtja konsideron se aktakuza e prokurorisë, si në pjesën e përshkrimit faktik, po edhe ate juridik është e pabazuar dhe si e tillë e paqëndrueshme sepse nuk është vërtetuar me asnjë provë bindëse se në rastin konkret dhe në ditën kritike të ketë ndodhur kjo ngjarje, e aq më pak nuk është vërtetuar pretendimi i prokurorisë se e tëra kjo ka ndodhur për shkak të një konflikti të mëparshëm në mes tyre. Sepse sot nga deklarimi i të pandehurit dhe në procesin 12.02.2024, nga deklarimi i të dëmtuarit u dëshmua qartë se në asnjë moment këto dy pal nuk kanë pasur asnjë mosmarveshje në mes vete.

Andaj në mungesë të provave ne kërkojmë nga gjykata, që pas shqyrtimit dhe elaborimit të tërë kësaj shtate, të pandehurin K.S ta liroj nga përgjegjësia penale për këtë vepër penale, sepse me asnjë veprim të vetëm i njëjti nuk është involvuar në këtë vepër.

I akuzuari K.S deklaroi: e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses sime.

Pas analizimit të provave të administruara dhe mbrojtjes së të akuzuarit, gjykata konstatoi; se natën kritike tani I akuzuari K kishte dalë me veturen e tijë "O.. C..." në rruget e Gjilanit, duke përfshi rrugën nga Posta e Madhe. Këtë fakt I akuzuari vete e ka pranuar.

Pastaj nga dëshmia e dëshmitarve B.Th-hetues policer dhe B.A zyrtar policor nga Forenzika, është vërtetu se jan fotografuar automjetet e të akuzuarit dhe të dëmtuarit dhe është konstatu, se vetura "M..." ka një dëmtim-shtypje në derën e vozitsit, ndërsa vetura "O. C..." një dëmtim në pjesën e përparme të djathtë në mbrojtësin e përparëm. Këto dëmtime përputhen pjesërisht edhe me deklaratën e të dëmtuarit Rr.R, I cili kishte deklaruar se vetura e tijë ishte goditë edhe në derën e vozitsit nga vetura "O.. C...." te cilën e drejtonte K.S-I akuzuar.

Gjykata është e bindur se natën kritike, I akuzuari K e ka goditur me veturën e tijë "O.. C...", me pjesën e përparme të vetures-me mbrojtshin, veturën "M..." të cilën e drejtonte Rr.R tani I dëmtuar.

Ndërkaq në anën tjetër, gjykata nuk ka mundur të vërtetoi se I akuzuari K te ketë posedu armë-revolë dhe të ketë drejtuar nga I dëmtuari Rr, ashtu siq pretendon I dëmtuari. Ketë rrethane I dëmtuari e ka përmende vetem në séancë gjyqsore.

Gjykata është e bindur se nuk kemi elemente të veprës penale vrasje në tentativë, sepse per një gjë të tillë duhet të egzistoi dashja e të akuzuarit qe ta privoi nga jeta të dëmtuarin, që në ketë rast nuk është vërtetu.

Për ketë arsye, gjykata ka bërë rekualifikimin e veprës penale nga vrasje në tentativë nga neni 147 lidhur me nenin 20 te KPK-së, në veprën penale kanosje nga neni 161 par.2 te KPK-se.

Për veprën penale kanosje nga neni 161 par.2 te KPK-së. është e parapare maksimumi I denimit deri ne 5 vite burg, ndërsa sipas nenit 90 paragrafi 1 pika 4, parashkrimi ndodhë pese vjet nga kryerja e veprës penale të denueshme me me shumë se tre vite burg.

Sipas nenit 91 par 6 te KPK-se, ndjekja penale ndalohet në cdo rast kur të ketë kaluar dyfishi I kohës se afatit të parashkrimit (parashkrim absolut I ndjekjes penale).

Nga koha e kryerjes së kësaj vepre penale me datë 18.02.2012, e deri me tani kanë kaluar me teper se dhjetë vite, ashtu që kemi të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes penale për ketë vepër.

Për ketë arsye u vendos si në dispozitiv të ketijë aktgjykimi

Shpenzimet e procedurës kanë mbetë në barrë të mjeteve buxhetore te KGJK-së.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në contest civil.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN
DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA
Me dt, 04.03.2024

Sek. Jurdike,
Kadrije Zymberi

Kryetari i trupit gjykues
Naser Maliqi

KSHILLA JURIDIKE: kunder ketij aktgjykimi, palet e paknaqura munde te ushtrojne ankese ne afat prej 30 ditesh, nga dita e marrjes ne Gjykatën e Apelit te Kosoves ne Prishtine, e nepermes kesaj Gjykate.